VENDIM
Nr. 64/2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 47/2013 "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 47/2013 "Për caktimin e përbërjes së sekretariateve të Kuvendit" bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Musa Ulqini (PS) caktohet sekretar i Sekretariatit për Procedurat dhe Votimin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 21.5.2015